

## KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTE

Sot më datë, 29/09/2023 (dymije e njëzetetë), në Tiranë lidhet kjo kontratë Shitblerje Kuotë (në vijim referuar edhe si "**Kontrata**"), midis palëve si në vijim:

- **Z. Arbion Qëndraj** atësia Arben, amësia Valbona, shtetase shqiptare, lindur në Tepelenë më 27/03/1998 dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. "Thoma Koxhaj", me kartë identiteti Nr. 034331964 dhe Nr. Personal J803270200, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (në vijim referuar edhe si "**Shitësi**");
- **Z. Mikel Hoxha** atësia Fadil, amësia Florije, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë më 24/05/1997 dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. "Çesk Zadeja", me kartë identiteti Nr. 032778718 dhe Nr. Personal J803270200, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (në vijim referuar edhe si "**Shitësi**");

dhe

- **Z. ELSON HOXHA**, atësia Fadil amësia Florije, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 21/03/1994 dhe banues në Tiranë me adresë "Çesk Zadeja", me kartë identiteti Nr. BR1585870 dhe Nr. Personal J40321054K me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (në vijim referuar edhe si "**Blerësi**");

(në vijim Shitësi dhe Blerësi referohen bashkarisht edhe si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**").

### *Kushtet paraprake*

- Shitësit janë pronar secili i një kuote, më specifikisht Z. Arbion Qëndraj zotëron një kuotë të barabartë me 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar dhe Z. Mikel Hoxha zotëron një kuotë të barabartë me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar (në vijim referuar edhe si "**Kuotat**") të shoqërisë të së drejtës shqiptare "Get The Key.al" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, NUIS: M21927016D me seli në Rr. Hasan Vogli, Rezidenca EURO3D, Selitë Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "**Shoqëria**");
- Shitësit dëshirojnë ti shesin secili Kuotën e tij Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotat nga Shitësit, sipas kushteve dhe afatve të përcaktuara në vjim.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, bien dakord si në vijim:

### **Neni 1**

#### **Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

### **Neni 2**

#### **Shitja e Kuotës**

2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësit i shesin dhe transferojnë Blerësit, i cili pranon dhe blen Kuotën nga secili shitës, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

2.2. Titulli i pronësisë të Kuotës nga secili Shitës tek Blerësi transferohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

2.3. Blerësi, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shitësit, dhe si ortak i Shoqërisë merr përsipër detyrimet dhe pasivet

e mundshme të Shoqërisë në proporcion me Kuotën e tij duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

2.4. Me transferimin sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- **Z. Elson Hoxha** do të zotërojë një kuotë të barabartë me 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

### **Neni 3**

#### **Çmimi**

3.1 Transferimi i Kuotave parashikuar në nenin 2.1 më sipër kryhet dhe pranohet për çmimin e rënë dakord nga Palët i cili përkon me vlerën nominale të secilës Kuotë me një vlerë totale në 7,000 lekë (shtatë mijë) nga blerësi (në vijim referuar si "**Çmimi**").

Blerësi pranon të likujdoj secilin prej oratkëve për vlerën e kutës e cila është e barabartë me 4,000 Lekë (katër mijë) kuota e blerë nga shitësi Arbion Qëndraj dhe 3,000 lekë (tre mijë) kuota e blerë nga shitësi Mikel Hoxha.

3.2. Palët pranojnë se Çmimi i shitjes së kuotave është likujduar palës shitëse me nënshkrimin e kësaj kontratë; dhe nuk ka ndonjë pretendim nga palët.

### **Neni 4**

#### **Deklarime dhe Garanci të Palëve**

4.1 Shitësi garanton Blerësin së është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër, në emër të tij, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuotat objekt e kësaj kontrate janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë, detyrim, apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

4.3 Blerësi deklaron se hyn në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet. Në fakt, Blerësi deklaron se pranon plotësisht situatën financiare të Shoqërisë që rezulton deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.4 Në përputhje me dispozitat e pikës 4.3, më sipër, Blerësi pranon shprehimisht dhe pa asnjë rezervë të blejë Kuotat.

### **Neni 5**

#### **Shpenzimet**

Shpenzimet ligjore dhe kontabël, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me regjistrimin e kësaj Kontrate, do të jenë në ngarkim të Blerësit.

### **Neni 6**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.

6.2 Nëse nuk arrihet të zgjidhet mosmarrëveshja me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet eskuzivisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

### **Neni 7**

#### **Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

### **Neni 8**

#### **Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet**

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e Kuotës nga Shitësi tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me të

njëtin objekt. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontratë vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga të gjitha Palët.

**Neni 9**  
**Origjinalet**

Kjo Kontratë është lidhur në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të tëra të nënshkruara nga Palët.

\*\*\*\*

SHITËSI

\_\_\_\_\_

**Arbion Qëndraj**

*Arbion Qëndraj*

**Mikel Hoxha**

*Mikel Hoxha*

BLERËSI

*Elson Hoxha*

**Elson Hoxha**

